



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

PRISHTINË, 16 DHJETOR 2010
NR. REF.: RK 72/10

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 61/09

**Parashtruesi
“Adler Com” Sh.p.k. nga Gjakova**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë të Urdhrit të Kryetarit të Komunës së
Gjakovës, i datës 22 janar 2008**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi

1. Parashtruesi është kompania “Adler Com” Sh.p.k. nga Gjakova, përfaqësuar nga pronari z. Brahim Gutaj, banor i Gjakovës.

Vendimi i sfiduar

2. Parashtruesi sfidon Urdhrin e Kryetarit të Komunës së Gjakovës, të datës 22 janar 2008.

Objekti i çështjes

3. Objekti i kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Urdhrit të Kryetarit të Komunës së Gjakovës, me pretendimin që janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë. Në veçanti, parashtruesi mbështet pretendimin e tij në nenet 3.1 [Barazia para Ligjit], 24 [Barazia para Ligjit], 49.1 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe Nenin 119.1, 2 dhe 3 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, nenet 20 dhe 22.7 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i datës 16 dhjetor 2009 (Nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtutjeshëm: Ligji) dhe Neni 54 (b) i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm: Rregullorja e Punës).

Procedurat para Gjykatës

5. Më 27 tetor 2009, parashtruesi i kishte parashtruar një letër Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm: Gjykata), duke kërkuar nga Gjykata shqyrtimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së Urdhrit të Kryetarit të Komunës së Gjakovës, të datës 22 janar 2008.
6. Më 10 dhjetor 2009, Gjykata informoi parashtruesin që ai duhet të përdor formularin e Gjykatës për të parashtruar kërkesën e tij. Më 15 mars 2010, Gjykata ia tërhoqi vëmendjen parashtruesit që ajo ende nuk kishte pranuar formularin e kërkesës.
7. Më 31 mars 2010, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
8. Më 06 prill 2010, Gjykata i dërgoi një kërkesë parashtruesit për të siguruar dokumentacion shtesë.
9. Më 07 korrik 2010, në pajtim me Nenin 22 të Ligjit, kërkesa i është komunikuar Kryetarit të Komunës së Gjakovës, i cili deri më tani nuk ka dorëzuar asnjë koment.
10. Më 15 dhjetor 2010, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportuese, Ivan Čukalović, Kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët Almiro Rodrigues (kryesuesi), Snezhana Botusharova dhe Gjyljeta Mushkolaj, ia rekomanduan atë Gjykatës së plotë.

Përmbledhje e fakteve

11. Siç duket nga parashtresat e parashtruesit, më 22 janar 2008 Kryetari i Komunës së Gjakovës urdhëroi Menaxherin e Zyrës së Prokurimit të Komunës që të mos ia jap asnjë tender parashtruesit gjatë vitit 2008, për shkak të kontestit me institucionet komunale. Siç duket kontesti ka të bëjë me procedurat gjyqësore të ndërmarra nga Kryetari i Komunës, para Gjykatës për Kundërvajtje në Komunën e Gjakovës, në lidhje me shkeljen e pretenduar të neneve 61 dhe 62 (2) dhe (3) të Rregullore Komunale nr. 4/2002 për rregullimin e qytetit dhe shërbimeve komunale të kryera nga parashtruesi.

12. Gjykata për Kundërvajtje (numri i regjistrimit nr. 04-771/07, i datës 18 shkurt 2009) ka pezulluar procedurat mbi bazën se nuk ka pasur prova të qëndrueshme që parashtruesi ka kryer shkeljet në fjalë. Për këtë arsye, Gjykata ka vendosur që pretendimet e Kryetarit të Komunës së Gjakovës ishin të pabaza.

Pretendimet e parashtruesit

13. Parashtruesi pretendon që Urdhri i Kryetarit të Komunës (në tekstin e mëtutjeshëm: Kryetari), i datës 22 janar 2008, shkel nenet 3.1 [Barazia para Ligjit], 24 [Barazia para Ligjit], 49.1 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe Nenin 119.1, 2 dhe 3 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm: Kushtetuta).
14. Për më tepër, parashtruesi pretendon që ka shkelje të Nenit 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, që përcakton se Kryetari i Komunës nuk gëzon autoritetin që të përfshijë veten në çështjet e prokurimit. Prandaj, sipas mendimit të parashtruesit, Kryetari i Komunës së Gjakovës nuk mund të nxjerr Urdhrin e datës 22 janar 2008.
15. Ai po ashtu pretendon që kryetari ka shkelur Nenin 81 (1) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, për shkak se Urdhri, para se t'i dorëzohet parashtruesit, duhet t'i nënshtrohet procedurës së shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë nga ana e autoritetit mbikëqyrës dhe atë në pajtim me Nenin 80 (1) të këtij ligji.
16. Sipas parashtruesit, arsyeja themelore e përjashtimit të tij nga tenderët komunale gjatë vitit 2008 ka qenë procedura e nisur në Gjykatën për Kundërvajtje të Gjakovës dhe për shkak se ai kishte një kontest me institucionet komunale.
17. Siç pretendon parashtruesi, përjashtimi nga pjesëmarrja në çfarëdo tenderi i ka shkaktuar atij dëme materiale dhe morale.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

18. Në mënyrë që të jetë në gjendje të vendosë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të kontrollojë nëse parashtruesi ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregulloren e Punës.
19. Në lidhje me këtë duhet të theksohet Neni 113.7 i Kushtetutës dhe Neni 47.2 i Ligjit, që përcaktojnë se individët që parashtrojnë një kërkesë në Gjykatë duhet të dëshmojnë se kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.
20. Arsyeja e rregullit për shterjen e mjeteve juridike është që t'u jepet autoriteteve në fjalë, edhe gjykatave, mundësia për të parandaluar apo për të korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin që rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive në rast të shkeljes së të drejtave të garantuara me Kushtetutë.
21. Megjithatë, sa i përket kërkesës në fjalë, del që parashtruesi nuk ka kërkuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që, në pajtim me Nenin 95 (2) të Ligjit Nr. 2003/17 për Prokurimin Publik në Kosovë, të shqyrtojë Urdhrin e Kryetarit të Komunës së Gjakovës.
22. Për më tepër, vendimet e marra nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, në bazë të Nenit 95 (2) të Ligjit për Prokurim Publik në Kosovë, mund të shqyrtohen nga një gjykatë me juridiksion kompetent në pajtim me ligjin e zbatueshëm për shqyrtimin gjyqësor

të çështjeve administrative (Ligji Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, i datës 22 korrik 2005) e që në këtë rast është Gjykata Supreme e Kosovës, në mbështetje të Nenit 31 (5) për gjykatat e rregullta (Gazat Zyrtare nr. 46/76 e Krahinës Socialiste Autonome e Kosovës).

23. Përveç kësaj, parashtruesi ka dështuar të paraqesë prova “prima facie” që është viktimë e shkeljes së të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë (shih Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, vendim i GJEDNJ për pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, i datës 31 maj), meqenëse ai nuk ka deklaruar në kërkesë nëse ka konkurruar për ndonjë tender përkatës dhe nëse atij nuk i është dhënë ndonjë tender për shkak të Urdhrit të Kryetarit të Komunës së Gjakovës.
24. Gjithashtu, Gjykata thekson që parashtruesi ankohet për Urdhrin e Kryetarit të Komunës së Gjakovës, i datës 22 janar 2008. Kjo do të thotë që kërkesa ka të bëjë me ngjarje para 15 qershorit 2008, e cila është data e hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, kërkesa është e pasafatshme, dhe si e tillë, në mospërputhje *ratione temporis* me dispozitat e Kushtetutës dhe Ligjit (shih *mutatis mutandis Jasiūnienė kundër Lituanisë, Kërkesa nr. 41510/98, Aktgjykimet e GjEDNJ-së të 6 marsit dhe 6 qershorit 2003*).
25. Rrjedhimisht, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të Nenit 113.7 të Kushtetutës, Nenit 20 të Ligjit, si dhe Nenit 54 (b) të Rregullores së Punës, në seancën e datës 16 dhjetor 2010, njëzëri:

VENDOS

- I. **TË REFUZOJË** kërkesën si të papranueshme.
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me Nenin 20 (4) të Ligjit.
- III. Ky vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportuese

Ivan Čukalovič, d.v.



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani, d.v.